



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2021:007816

Datë: 22.03.2021

Numri i dokumentit: 01617473

P.nr.78/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues, Minir Hoti me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fatmire Podvorica dhe bashkëpunëtorin profesional Izet Hyseni në çështjen penale kundër të akuzuarit D. J., për shkak të veprës penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 par. 2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.147/2020/E të dt.26.01.2021, pas mbajtjes së seancës të shqyrtimit fillestar me datë 17.03.2021 në praninë e Prokurorit të Shtetit Ferdane Sylejmani dhe të akuzuarit, në të njëjtën ditë në prezencë të palëve mori publikisht shpalli, ndërsa me datë 22.03.2021 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

D. J., nga i ati H. dhe nëna H., e vajzërisë M., i lindur më dt.... me vendbanim fshatin O., Komuna e Podujevës, me numër personal të identifikimit:....., ka të kryer shkollën fillore, profesioni i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike-financiare, i pa martuar, Shqiptar-Kosovar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me datë 17.11.2020, rreth orës 15:00, në Podujevë, në rrugën “Z. P.”, në një lokal me mbishkrimin “S.”, i pandehuri me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, me dashje ka organizuar lojëra të fatit, i cili nuk ka pasur licensë apo leje të organit kompetent për këtë veprimtari, të cilën e ka ushtruar në mënyrë të kundërligjshme, ku në lokal janë gjetur 6 (gjashtë) aparate të tipit merkur, pa numër serik, në të cilët janë të instaluara lojëra të fatit, ku edhe janë gjetur të hollat në shumën prej 727.05 Euro, të cilat ishin futu në këtë aparate për të luajtur në lojëra të fatit.

-Me këtë ka kryer veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 par. 2 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 69, 70, dhe 294 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 115, 365, 366, 369, 370, 450, 453 të KPPRK-së, e:

G J Y K O N

Të akuzuarin me dënim me kusht, ashtu që i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do ta ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit prej 1 (një) viti nuk kryen veprë të re penale, pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Konform nenit 115 të KPPRK, të akuzuarit gjithashtu i konfiskohen: 6 Aparate të lojërave të Fatit të tipit M.... pa numra serik, si dhe shuma e parave në vlerë prej 727.05 Euro, si mjete të kryerjes së veprës penale.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20€ (njëzet/€uro) dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30€ (tridhjetë/€uro) të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.147/2020/E të dt.26.01.2021, kundër të akuzuarit D. J., për shkak të veprës penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 par. 2 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më dt. 17.03.2021, në të cilën prezantuan Prokurori i Shtetit Ferdane Sylejmani nga Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe i akuzuari.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit i akuzuari në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi: E pranoj fajësinë është e vërtet si në aktakuzë, lokalim e kam hapur dy javë para se të mbyllet, këtë e kam bërë për shkak të gjendjes së dobët ekonomike, jam i pa punë me pension të veteranit të U...-së, asnjëherë më parë nuk kam qenë i dënuar, lus gjykatën që të më shqiptoj një dënim sa më të lehtë.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimit të fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimit të fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi: E pranoj pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pranimit të fajit u bë me vullnetin e tij të plotë pa kurrfarë presioni dhe konform dispozitave ligjore të KPPRK-së, andaj i propozoj gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë.

Gjykata pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par. 1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së, ka vazhduar me shqyrtimin e dënimit.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit, përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 par. 2 të KPRK-së, e për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penalo-juridik është përgjegjës, për çka edhe u shpall fajtor dhe iu shqiptua dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i akuzuari në shqyrtimit fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ndërsa si rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti, andaj gjykata ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi konfiskimin e sendeve të mbajtura, në mënyrë të paautorizuar si mjete të kryerjes së veprës penale, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 115 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor u morr në bazë të nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPRK-së dhe vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marrë, konform nenit 39 par.3 nënpar 3.1 të Ligjit nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal
P.nr.78/2021, me dt.22.03.2021

Sekretare Juridike
Fatmir Podvorica

Gjyqtari i vetëm gjykues
Minir Hoti

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.